

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligji nr. 03/1-079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësor edhe atë komerciale, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Borčić, anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese:**

B.K. nga ...a,

Ankesa e ushtruar nga i autorizuari i paditësit, Avokat T. B.i nga ...,

Kundër:

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, (AKKVP),

Padi- ankesë për anulimin e Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore

HPCC/REC/85/2006, të datës 11 Dhjetor 2006

Duke vendosur lidhur me Ankesën e paraqitur me datë 18.11.2019, si dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të datës 24.02.2020, kundër Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore,(tutje; KÇPB),nr. HPCC/REC/85/2006, të datës, 11 Dhjetor 2006, bazuar në nenin 13.3, nenin 12.2, të Rregullores së UNMIK 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, dhe nenin 196 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, pas shqyrtimit të mbajtur me datë 11 Mars 2020, kolegji merr:

AKTGJYKIM

Hedhet Poshtë si e palejuar Ankesa e B. K. e datës 18.11.2019, si dhe propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit i datës 26.02.2020, të parashtuara nga përfaqësuesi sipas autorizimit avokat, T. B., kundër Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, HPCC/REC/85/2006, të datës 11 Dhjetor 2006.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

1. Me padinë-ankesën e ushtruar, pala ankuese e atakon Vendimin e Komisionit për Çështje Pronësore Banesore HPCC/REC/85/2006, të datës 11 Dhjetor 2006, (me të cilin vendim janë vendosur kërkesat DS 0031648, e palës kërkuese Xh. G., dhe kërkesa DS002009 ,e palës përgjegjëse R. S.), e me të cilin është ndryshuar vendimin e shkallës së parë, HPCC/D/180/2005/A&C, i datës 30 prill 2005, andaj kërkon që i njëjti të anulohet si jo ligjor dhe jo i drejtë.
2. Në ankesë thekson se sipas vendimit të ankimuar, pala R. S. ka qenë i përjashtuar nga procedura në këtë lëndë, e po ashtu edhe blerësi i parë M. K.a, e më vonë edhe pala

ankuese B. K., të cilëve u është pa mundur atakimi i këtij vendimi në atë kohë me ankesë, andaj me që tani e kanë kuptuar, (e cek datën 25.10.2019), për këto arsye me ankesë kërkon mbojtje gjyqësore kundër këtij vendimi, sepse është posedues i ndërgjeshëm i banesës lëndore, në të cilën e ka fituar të drejtën pronësore në mënyrë të ligjshme me blerje nga D. S. dhe kontratë të vërtetuar në gjykatë me datë, 25.10.2005.

3. Me datë 24.02.2020, në gjykatë supreme pala ankuese parashtron, propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit me të cilin propozon që, kundërshtares së sigurimit Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, ti ndalohej ta shqetësoj paditësin në shfryzimin dhe posedimin e banesës së tij, e cila gjendet në ..., ..., deri të përfundoj kontesti me vendim të formës së prerë për pengim posedimi, e cila çështje evidentohet me nr. të lëndës, C. nr. 3971/2019.

Arsyetimi ligjor;

-Juridiksioni,

4. Gjykata Supreme, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndëve sipas ankesës të ish Agjencisë Kosovare të Pronave, tani Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, pas shqyrtimit të ankesës si dhe propozimit për caktimin e masës së përkohshme gjen se, nuk ka juridiksion për të shqyrtuar dhe Vendosur lidhur me vendimin e atakuar me ankesë dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme.
5. Me Vendimin e ankimuar të shkallës së dytë të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore nr. HPCC/REC/85/2006, të datës 11 Dhjetor 2006, është aprovuar kërkesa për rishqyrtim e palës ankuese Xh. G. e kategorisë A, nr. ..., ndërsa është ndryshuar Vendimi i shkallës së parë i komisionit nr. HPCC/180/2005/A dhe C, i dt. 30 Prill 2005, duke vendosur si në parag a), b), dhe c), të vendimit individual dhe si në vendimin grupor, (shih Vendimin e shkallës së dytë të ankimuar dhe të shkallës së parë).
6. Sipas nenit 2.7, të Rregullores së UNMIK, nr.1999/23, të datës 15 Nëntor 1999, Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i ri shqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.
7. Vendimi i ankimuar, HPCC/REC/85/2006, është përfundimtar- i formës së prerë, dhe në pajtim me nenin 2, paragraf 7, të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23. I njëjti nuk mund të ankimohet, as sipas Rregullores së UNMIK nr.2000/60, sepse dispozitat e këtyre dy rregulloreve nuk parashohin ndonjë mjet juridik të rregullt, apo të jashtzakonshëm të goditjes kundër vendimeve përfundimtare të KÇPB.
8. Sipas dispozitave të Rregullores së lartë cekur, pas vendosjes me vendimin e shkallës së dytë, çështja e vendosur trajtohet, *res judicata*, sepse sipas nenit 2.5, të kësaj Rregullore në çështjet e pronave banesore, juridiksioni i gjykatave lokale ishte përjashtues, ndërsa komisioni ka

kompetencë ekskluzive për të zgjidhë kategoritë e kërkesave të theksuara si në nenin 1.2, të kësaj rregullore.

9. Ngjajshëm është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës sa i përket vendimeve të formës së prerë, të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore,(shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin me numër KI 104/10, e në mënyrë specifike paragrafët, 64-75, të këtij aktgjykimi).
10. Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 13, par. 1 dhe 2 dhe neni 13. 3 c), të Rregullores së UNMIK, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin, nr. 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshilla Juridike;

11. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm, i njëjti nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË **GSK-KPA-A-005/19, me datë 11 Mars 2020**

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani